



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.06.09.2023]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**OPERATORIT EKONOMIK “ZENIT & CO” shpk**

ADRESA: TIRANE RRUGA "MYRTEZA TOPI", ND.18, AP.38

Procedura e prokurimit/lotit: **“Shërbim konsulence”**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-73545-06-23-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Hartim i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit”.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 60 datë 3 Korrik 2023

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

**Operatori ekonomik “ZENIT & CO” shpk**

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar ofertuesi me vlerat përkatëse të ofruara:

**Operatori ekonomik “ZENIT & CO” shpk me NUIS K61731002D**

1. Vlera e ofertës pa tvsh = **4.105.000 (katër milion e njëqind e pesë mijë) lekë** dhe totali i pikëve të marra **93.6 (nëntëdhjetë e tre pikë gjashtë) pikë.**

Lista e operatorëve ekonomikë të s'kualifikuar:

**Operatori ekonomik “Adriatica RC“ sh.p.k me NUIS M01506035F**

**S'kualifikuar në fazën e parë për arsyet e mëposhtme:**

AK në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të modifikuar me anë të shtojcës: “Për një ndryshim dhe saktësim në DST për procedurën e prokurimit me objekt: “Hartim i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit” nder te tjera ka kërkuar shprehimisht si më poshtë vijon:

- a. **1 (një) Ekspert Kryesor/MenaxherProjekti – Eksperti Kryesor/Drejtuasi i ekipit duhet të ketë Diplomë të nivelit Master Shkencor në Inxhinieri Agrare ose Diplomë të Nivelit Master Shkencor në Biologji Mjedisore ose ndonjë fushë tjetër të ngjashme.**

-Eksperti kryesor ose menaxheri i projektit ofron udhëzime në hartimin dhe zbatimin e veprimeve specifike për të ndihmuar planin vendor të veprimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit. Bën rishikimin, modifikimin të gjitha aktiviteteve të planit dhe produktet që lidhen me biodiversitetin në përputhje me dokumentet e planit. Ai mundëson zhvillimin e kushteve të nevojshme për ekspertët e që do të përfshihen në hartimin e planit.

- f. **1 (një) specialist hedhje të dhënash –Duhet të ketë Diplomë Universitare Bachelor/Master Shkencor në IT ose Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.**

-Specialisti i hedhjes së të dhënave do të kryejë procesin e inventarizimit të biodiversitetit (hedhjes së të dhënave në kompjuter). Do të kryej përditësimin e të dhënave të ndryshme që kanë lidhje me habitatet, speciet, zonat e mbrojtura dhe kërcenimet.

Nga verifikimi i bërë shtojcës 12 ”Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” konkretisht seksionit **B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) konstatohet se:**

Në përmbushje të kriterit si më sipër cituar operatori ekonomik “Adriatica RC” shpk ka deklaruar se drejtues ekipi /Menaxher projekti do të jetë Z. Enkelejd Musabelliu për të cilin është deklaruar se zotëron dy diploma: Diplomë MSC “Ekonomi Politike Europiane” dhe Diplomë për “Filozofi” ndërkohë që referuar përcaktimit të bërë në kriterin si më sipërcituar kërkohet që Drejtuesi i ekipit duhet të ketë Diplomë të nivelit Master Shkencor në Inxhinieri Agrare ose Diplomë të Nivelit Master Shkencor në Biologji Mjedisore ose ndonjë fushë të ngjashme. Diplomat e deklaruara për Z. Enkelejd Musabelliu nuk përkojnë me asnjë nga llojet e diplomave të kërkuara në këtë kriter dhe nuk janë të ngjashme me diplomat e kërkuara.

Në vijim të deklaratës për stafin operatori ekonomik “Adriatica RC” shpk ka deklaruar se specialist për hedhjen e të dhënave do të jetë Znj Erta Marku e cila është deklaruar se është

eksperte financash me diplomë në Bachelor në financë dhe MSC në Kontabilitet dhe Auditim ndërkohë që në shtojcën bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit është kërkuar që specialisti për hedhjen e të dhënave duhet të zotërojë Bachelor/Master në IT ose Teknologji Informacioni.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80, nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik” dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 79, neni 80, neni 82 **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **2. Operatori ekonomik “ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS“ SH.P.K me NUIS K81317002P**

### **S’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:**

Në formularin e kriterëve të përgjithshme dhe në shtojcat e DST-së objekt prokurimi është kërkuar si më poshtë vijon:

*Ofertuesi deklaron se:*

*ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*

### **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

#### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>
<b><u>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si</u></b>

**aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:**

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim

është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë verifikimit të shtojcës 12 “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme” të paraqitur nga operatori ekonomik “Environmental Management Consultants“ sh.p.k në SPE konstaton se nuk janë përcaktuar me emra konkretë **personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik** më konkretisht nuk është përcaktuar emri i Znj. Elidiana Shehu në cilësinë e administratores dhe emri i Znj Ermelinda Agalliu në cilësinë e drejtuesit teknik pasi referuar verifikimit të bërë gjithashtu edhe ekstraktit të regjistrimit tregëtar të operatorit ekonomik “Environmental Management Consultants“ sh.p.k konstatohet se Znj. Elidiana Shehu figuron në cilësinë e administratores dhe emri i Znj Ermelinda Agalliu figuron në cilësinë e drejtuesit teknik.

KVO gjykon se formati standart i shtojcës 12 ”Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme”, është ndërtuar i tillë që kërkon **domosdoshmërisht** citimin e cilitdo anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, të operatorit ekonomik të cilët nuk duhet të jenë ose të kenë qënë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP.

KVO citon se shtojca 12 “Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme” nuk lë vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik.

Ju bëjmë me dije se në shtojcën e kritereve të përgjithshme formati i miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik kërkon që të citohen të gjithë emrat konkretë të të gjithë personave dhe subjekteve që kanë rol vendimmarrës pranë shoqërisë përkatëse duke përfshirë në rastin konkret edhe administratorin edhe drejtuesin teknik.

Në rregullat e prokurimit, DST, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”Seksioni 1, Hartimi i ofertës, ne pikën 1.1 thuhet shprehimisht;

Citoj... 1.1 *Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT.*

*Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.*

Përsa cituam më lart shtojca mbi deklaratën e kriterëve të përgjithshme do të konsiderohet e paplotë dhe për rrjedhojë e pavlefshme.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

**2.**Operatori ekonomik “Environmental Management Consultants“ sh.p.k nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës duke rënë në këtë mënyrë ndesh me përcaktimin e bërë në pikën 2 gërma (b) të kriterëve të veçanta për kualifikim.

**3.**Nga verifikimi i bërë shtojcës 12 vërehet se operatori ekonomik në Seksionin B “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive ka cilësuar vetëm listën emërore por nuk ka cituar llojin e diplomave përkatëse për secilin prej stafit të konsulentit element i cili në këtë fazë të procedurës është i rëndësishëm për vlerësim dhe për efekt krahasueshmërie më pas me dokumentacionin provues i cili do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit duke rënë ndesh me përcaktimin e bërë në kriterin 2.3.2 të modifikuar sipas shtojcës dt 05.07.2023.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80, nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik” dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 79, neni 80, neni 82 **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **3. Operatori ekonomik “Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisja” me NUIS K51726021G**

**S’kualifikuar në fazën e parë për arsyet e mëposhtme:**

- 1. AK në kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim konkretisht në rubrikën “Kapaciteti Ekonomik edhe Financiar” ka kërkuar si më poshtë vijon:**

*“Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, **të konfirmuara nga ky autoritet** që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.*

Nga verifikimi i bërë bilanceve të paraqitura nga ky operator për vitin 2020,2021 dhe 2022 rezulton se këto bilance janë të pakonfirmuara nga autoritetet përkatëse duke rënë ndesh në këtë mënyrë me përcaktimin e bërë në pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim. Operatori ekonomik ka ngarkuar se bashku me ofertën e tij print screen të aplikimit të bërë në e-filing në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në dt 06.07.2023 për çertifikimin e bilanceve por ky aplikim nuk ofron asnjë të dhënë apo informacion lidhur me çertifikimin apo konfirmimin e këtyre bilanceve nga autoriteti përkatës.

2.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit në vijim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik sa më sipër cituar vëren se nuk është paraqitur shtojca Nr.7 mbi "Disponueshmërinë e stafit të konsulentit" ku thuhet shprehimisht se: ***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë*** e cila duhet të plotësohet nga operatori ekonomik ofertues për të gjithë stafin që do të vërë në dispozicion për realizimin e këtij shërbimi. Në fund të kësaj shtojce pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit është cilësuar gjithashtu se:

***"Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit".***

Mosparaqitja e kësaj deklarate bie ndesh edhe me përcaktimin e bërë në nenin 54 pika 10 gërma (a) të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku thuhet shprehimisht se:

***"Autoriteti/enti kontraktor, përveç kriterëve të përcaktuara në LPP, për skualifikimin e kandidatëve ose të ofertuesve duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit, nëpërmjet vetëdeklarimeve për situatat si vijon:***

a) ***Konfliktin ndërmjet konsulentëve. Konsulentët nuk mund të ofertojnë me të njëjtën përbërje të stafit. Për këtë qëllim, anëtarët e stafit të një konsulenti duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për konsulentin dhe mosangazhimin në konsulentë të tjerë ofertues në të njëjtën procedurë***".

3.Nga verifikimi i bërë shtojcës 12 vërehet se operatori ekonomik në Seksionin B Deklarata "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive" nuk ka cilësuar listën emërore dhe llojin e diplomave përkatëse për secilin prej stafit të konsulentit element i cili në këtë fazë të procedurës është i rëndësishëm për vlerësim dhe për efekt krahasueshmërie më pas me dokumentacionin provues i cili do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimimit duke rënë ndesh me përcaktimin e bërë në kriterin 2.3.2 të modifikuar sipas shtojcës dt 05.07.2023.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80, nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për "Prokurimin Publik" dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Neni 79, neni 80, neni 82 **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Për fazën e dytë nuk ka operatorë ekonomikë të s'kualifikuar.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik “ZENIT & CO” shpk**, me adresë: Tirane Rruga "Myrteza Topi", Nd.18, ap.38, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **4.105.000 (katër milion e njëqind e pesë mijë) lekë** pa tvsh/ totali i pikëve të marra **93.6 (nëntëdhjetë e tre pikë gjashtë) pikë** është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me marrjen/publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.